



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 1251/1 Prot.

27.02
Tiranë, më / /2024

URDHËR

Nr. 101, Datë 27/02 2024

“PËR SHPALLJEN E VENDIT VAKANT SI NOTER NË BASHKINË DIBËR”

Në mbështetje të nenit 6 dhe 7, të Ligjit nr.8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 11 të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, si dhe të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë me nr. 164 datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullave për procedurat e plotësimit të vendeve vakante si noter”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e vendit vakant si noter, në Bashkinë Dibër, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
2. Hapjen e procedurës për plotësimin e vendit vakant për noterë në Bashkinë Dibër, sipas rradhës së plotësimit përcaktuar në ligjin nr.110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar.
3. Ngarkimin e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë për marrjen e masave për zbatimin e këtij urdhri.
4. Publikimin e këtij urdhri në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Manja
Ulsi Manja

